



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 823/2 Prot.

Tiranë, më 21.04 2026

VENDIM  
Nr. 57 datë 21.04 2026  
PËR

**NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS  
DHE FONDACIONIT ALBITSOL**

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma "c" dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në nenin 20, pika "s" të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin të Rektoratit nr. 61 datë 15/04/2026**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **21/04/2026**,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Fondacionit Albitsol**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT**

**Prof.Dr. AGRON KASA**





## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**, me seli në Tiranë, Rruga Muhamet Gjollësja, përfaqësuar nga **Prof.Dr. Agron Kasa**, në cilësinë e Rektorit, (në vazhdim quhet "Universiteti"),

dhe

**ALBITSOL FOUNDATION** - Fondacion me te drejte Shqiptare, con Seli ne Shqiperi, Tirane, Rruga Saraceve n°27 , ne cilesine e perfaqesuesit ligjor, **Znj. Vasenka Leka** ("Fondacioni")

Meqenese:

Universiteti angazhohet në promovimin e sportit si një mjet edukativ dhe zhvillimor social, me vëmendje të veçantë për talentet e rinj në botën e sportit.

Fondacioni ka ndër objektivat e tij institucional promovimin e iniciativave sportive/kulturore që inkurajojnë përfshirjen sociale, integrimin ndërkulturor dhe zhvillimin personal e profesional të të rinjve.

Palët e njohin vlerën e futbollit si një mjet dialogu, miqësie dhe bashkëpunimi mes të rinjve, edhe të nacionaliteteve dhe kulturave të ndryshme.

Të dyja Palët dëshirojnë të bashkojnë aftësitë dhe burimet e tyre për organizimin periodik të **turneve dhe aktiviteteve sportive** që inkurajojnë pjesëmarrjen e skuadrave rinore nga kombësive të ndryshme, duke promovuar vlerat e fair play, përfshirjes dhe respektit të ndërsjellë.

Palët bien dakord si më poshtë:

### Neni 1 – Subjekti i Marrëveshjes

Palët angazhohen të bashkëpunojnë për organizimin, menaxhimin dhe promovimin e **turneve dhe aktivitete sportive**, që do të zhvillohet në strukturat sportive të Universitetit dhe në impiante të tjera të caktuara.

### Neni 2 – Objektivat

**Turnetë dhe aktivitetet sportive** kanë objektivat e mëposhtme:

- Të promovojnë dialogun dhe miqësinë ndërkombëtare përmes sportit.
- Të inkurajojë zhvillimin e talenteve të rinj të futbollit dhe sporteve të tjera nga vende të ndryshme të botës.



- Të krijojë mundësi edukative dhe formuese për pjesëmarrësit, me organizimin e aktiviteteve të ndryshme mbi tema të integritimit social dhe zhvillimit personal.
- Mbështetje për bashkëpunim ndërkombëtar mes institucioneve sportive dhe organizatave rinore.

### **Neni 3 – Angazhimet e Universitetit**

Universiteti angazhohet për:

- Të promovojë turnetë dhe aktivitetet sportive përmes kanaleve të tij institucionale dhe rrjeteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të ofrojë mbështetje teknike dhe administrative për menaxhimin e ngjarjeve sportive.

### **Neni 4 – Angazhimet e Fondacionit**

Fondacioni angazhohet për:

- Të kontribuojë financiarisht dhe logjistikisht në organizimin e turneve dhe aktiviteteve sportive.
- Të kujdeset për promovimin ndërkombëtar të ngjarjes, në bashkëpunim me partnerë të jashtëm dhe media.
- Të organizojë aktivitete paralele, si takime kulturore dhe formuese mbi temat e përfshirjes sociale, shëndetit dhe mirëqenies rinore.
- Të krijojë partneritete me institucione dhe sponsorë për të siguruar mbështetje ekonomike dhe operative për turnetë dhe aktivitetet sportive.
- Të ofrojë mbështetje teknike dhe administrative për menaxhimin e ngjarjeve sportive.

### **Neni 5 – Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe nuk kufizohet në kohë.

### **Neni 6 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që buron nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve ndërmjet Palëve. Në rast të mungesës së marrëveshjes, Palët mund të kërkojnë një arbitër të zgjedhur me dakordësi.



### **Neni 7 – Dispozitat përfundimtare**

Ky Memorandum nuk nënkupton ndonjë marrëdhënie subordinimi ose partneritet tregtar mes Palëve.  
Çdo ndryshim ose shtesë në këtë Memorandum duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja Palët.

Nënshkruar më, .../.../2026

**Prof.Dr. Agron KASA**

**Rektor**

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**Vasenka Rangu Leka**

**Përfaqësuese Ligjore**

**ALBITSOL FOUNDATION**